



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme (IV-të për v. 2012) e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 08.5.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **14:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylë, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Mungoi: Refik Ramaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Qazim Azemi – anëtari më i vjetër i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoi nga kryesuesi i seancës sqarim lidhur me rendin e ditës, duke shtuar se kërkesa e nënshkruar nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit për seancë të jashtëzakonshme, është nënshkruar vetëm me një pikë të rendit të ditës dhe atë zgjedhja e kryesuesit të kuvendit, kurse futja e dy pikave tjera është bërë në mënyrë të kontrabanduar dhe se të njëjtat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme, është nënshkruar me tri pika të rendit të ditës dhe propozoi që seanca t'i vazhdojë punimet konform rendit të ditës, i cili është propozuar në kërkesë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit-tha se së bashku me ftesë për mbledhje të jashtëzakonshme, është dashur të dërgohet edhe kërkesa e nënshkruar nga ana e anëtarëve të kuvendit për thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme dhe se me

këtë do të plotësohej ana ligjore e dispozitave të ligjit, statutit dhe rregullores së punës të kuvendit.

Haki Maloku, përgjegjës i Sekretarisë – duku je referuar ftesës së mbledhjes, tha se kjo seancë është thirrur konform kërkesës së bërë nga ana e anëtarëve të kuvendit dhe shtoi se në kërkesë janë të specifikuara saktë pikat e rendit të ditës, dhe se në këtë rast janë respektuar dispozitat e statutit dhe të rregullores së punës së kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- sqaroi se kërkesa për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme, është bërë me tri pika të rendit të ditës, dhe se në këtë rast nuk ka kurrfarë pengese që ky rend dite të procedohet për shqyrtim dhe aprovim nga ana e kuvendit. Tutje ai shtoi se dy projektet e cekura në rendin e ditës që kanë të bëjnë me ridestinimin, përkatësisht transferimin e mjeteve financiare, janë projekte shumë të rëndësishme, të cilat duhet të zhvillohen më tej dhe sqaroi se projekti i rrugës Pasomë-Rashan nuk ka qenë i planifikuar për projektet e vitit të kaluar, por që është bërë e mundur që së bashku me ministrinë dhe Komunën e Mitrovicës të bëhet asfaltimi i kësaj rruge. Ndërsa sa i përket transferimit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, për sigurimin e transportit të nxënësve vlerësoi se ky transfer është i natyrës imediate dhe urgjente.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke ju referuar nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, tha se ky nen është decidiv sa i përket thirrjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe shtoi se në rastin konkret e kuptoj urgjencën dhe arsyen e procedimit dhe votimit të këtyre projekteve, por se kuvendi është i obliguar që të respektojë dispozitat ligjore pozitive që e rregullojnë këtë materie.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 24 vota “për”, të tjerët “abstenim” miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Zgjedhja e kryesuesit të kuvendit të komunës.**
- 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore për projektet: asfaltimi i rrugës Pasomë-Rashan dhe ndërtim i shëtitorës –trotuarit në digën e lumit “Sitnica”.**
- 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transferin e mjeteve buxhetore nga projekti “transport” në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.**

1. Zgjedhja e kryesuesit të kuvendit të komunës.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- dha sqarime të përgjithshme lidhur me mënyrën e votimit dhe të zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit, me ç’rast lexoi nenin 33 të Udhëzimit Administrativ, për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se dorëheqja e kryesuesit të kuvendit ishte si rezultat i asaj se ai mbante dy poste, andaj u sugjeroi anëtarëve të kuvendit që mos të nominojnë për kryesues persona të cilët mbajnë pozita tjera në shërbimin civil, për faktin se mund të na përsëriten situata të njëjta.

Shpetim Zhegrova, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi si kandidat për kryesues të kuvendit Habib Mustafën.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit-në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së propozoi si kandidate për kryesues të kuvendit Bahrije Pllanën.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke ju referuar nenit 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr.2009/03, propozoi krijimin e komisionit për mbarëvajtjen e procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit.

Naile Osmani, anëtare e kuvendit-në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit për zgjedhjen e kryesuesit Shpëtim Zhegrovën.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- propozoi për anëtar të komisionit mbikëqyrës për zgjedhjen e kryesuesit Besim Jasharin.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit-propozoi për anëtar të komisionit Sabri Feratin.

Në fund kuvendi në mënyrë unanime vendosi që në përbërje të komisionit për mbarëvajtjen e procedurës së zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të jenë këta anëtarë:

- **Shpëtim Zhegrova,**
- **Besim Jashari dhe**
- **Sabri Ferati.**

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-verifikoi kuorumin, i cili konstatoi se prezent në sallë janë 33 anëtarë të kuvendit, mungoi Refik Ramaj dhe Sabit Kadriu.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- njoftoi për rrjedhën e procedurës së votimit dhe konstatoi se nga 35 anëtarë të kuvendit kanë votuar 33, dhe nga ky votim doli ky rezultat si në vijim: Habib Mustafa mori 20 vota me ç'rast u zgjodh Kryesues i Kuvendit të Vushtrrisë, ndërsa Bahrije Pllana mori 12 vota, kurse një votë ishte e pavlefshme.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- pasi u zgjodh kryesues i kuvendit mori kryesimin e seancës. Ai në vazhdim të fjalimit të tij falënderoi anëtarët e kuvendit për besimin e dhënë dhe shtoi se zgjedhja e tij do të jetë më tepër përgjegjësi se sa privilegj. Njëkohësisht ai ceku se do të angazhohet që kuvendi të ketë rrjedha normale dhe se në punën e tij do të zhvillohet fryma demokratike, si dhe të promovohet toleranca dhe liria e fjalës. Në fund ai tha se do të angazhohem që të kemi frymë bashkëpunimi me të gjithë anëtarët e kuvendit pa dallime politike dhe partiake, dhe se e gjithë puna e tij si kryesues i kuvendit do të bazohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, si dhe në ligjet dhe aktet tjera që rregullojnë çështjet e pushtetit lokal.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- pasi i uroi zgjedhjen kryesuesit, shprehu falënderim për të gjithë anëtarët që e votuan si kandidat për kryesues të kuvendit.

Kuvendi pas votimit me 20 vota "për", vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim Habib Mustafa, anëtar i KK-së zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Mandati i të lartpërmendurit në cilësinë e kryesuesit të kuvendit të komunës përfundon merastin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të KK-së.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore për projektet: asfaltimi i rrugës Pasomë-Rashan dhe ndërtim i shëtitores –trotuarit në digën e lumit "Sitnica".

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- dha sqarime të përgjithshme lidhur me projektin në fjalë, duke shtuar se ky projekt është i përbashkët mes komunës sonë, Komunës së Mitrovicës, dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe ceku se komunës sonë i është dhënë e drejta për shpalljen e tenderit për këtë projekt.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet ridestini i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (programi 644660) të shërbimeve publike, mbrojtjes civile, emergjencës (kodi i projektit 86140), Fondi për bashkëfinansim për shtruarjen e rrugëve me kubëza

betoni, vlera e projektit është 299,256.00 €, prandaj nga i njëjti program buxhetor nga projekti në fjalë ridestinohet shuma prej 53,046.21 € për këto projekte:

- *Ndërtimi i shëtitorës-trotuarit në bankinën e Lumit "Sitnica", vlera 12,797.65€;*
- *Asfaltimi i rrugës Pasomë-Rashan ,shuma 40,248.56€.*

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për transferin e mjeteve buxhetore nga projekti "transport" në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, (programi 644180), të shërbimeve publike, mbrojtjes civile, emergjencës (kodi i projektit 86152) "transport", vlera e projektit është 100,000.00 €, prandaj nga projekti në fjalë transferohet shuma prej 35,200.00 € në këtë program buxhetor:

- *Kodi 920, në Drejtorinë Arsimit, nënprogrami i arsimit, administrata (92120) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.*
-

Mbledhja përfundoi në orën 15:25.

Procesmbajtësi:

Bastri Duraku

Lektore:

Vlora Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa